

Shërbimet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese

- Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
- Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
- Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave e të ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve.
- Organizimi i aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimi dhe administrimi i institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.